



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Analiza Vjetore

2015

I. HYRJE

Reforma në Sistemin e Burgjeve mbetet padyshim një ndër elementet kryesore për funksionimin e shtetit të së drejtës. Duke kuptuar rëndësinë e sundimit të ligjit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe transformimin e sistemit në një mundësi rehabilitimi për personat me liri të kufizuar janë ndërmarrë një sërë angazhimesh për instalimin e një tradite të qëndrueshme dhe modeli efektiv për menaxhimin e institucioneve penitenciare. Realizimi i një reforme të suksesshme në sistemin e burgjeve do të siguronte krijimin e kushteve parësore për trajtimin me dinjitet të personave me liri të kufizuar, do të siguronte funksionimin e sistemit bazuar në standardet ndërkombëtare, duke siguruar një shërbim eficient dhe të sigurt për gjithë shoqërinë shqiptare.

Në bashkëpunim të ngushtë me partnerë ndërkombëtare dhe kombëtare, me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare viti 2015 mund të konsiderohet i rëndësishëm sa i përket projekteve të vëna në zbatim dhe qasjes së komunikimit me publikun. Masat e vëna në zbatim kanë nxitur llogaridhënien e institucioneve, kanë rritur përgjegjshmërinë në kryerjen e detyrave funksionale dhe kanë krijuar premisa për zhvillimin, menaxhimin dhe operacionalitetin e sistemit të burgjeve bazuar në modele të suksesshme të vendeve të Bashkimit Evropian, duke kontribuar në arritjen e objektivave për procesin e integritetit evropian të vendit.

Vizioni


Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve do të sigurojë për shoqërinë një sistem penitenciar eficient, nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjit, transparencës dhe respektit për dinjitetin njerëzor.

Analiza e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e vitit 2015 bazohet në Planin e Qeverisë Shqiptare për hartimin dhe zbatimin e një reforme rrënjësore në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, planin kombëtar për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian, si dhe angazhimet e ndërmarra në kuadër të procesit të integritetit evropian.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Me urdhrin Nr. 25, datë 27.01.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, u miratua Plani i Punës 2015 i DPB. Në përputhje me politikat e sigurisë kombëtare, politikat sociale e penale, duke synuar shndërrimin e sistemit penitenciar në një mundësi rehabilitimi, sipas fushës së veprimit të strukturave përbërëse të Drejtorisë së Përgjithshme është kryer procesi i identifikimit të nevojave prioritare, të cilat janë përkthyer në objektiva dhe aktivitete konkrete për çdo sektor. Prioritetet, objektivat, aktivitetet e planifikuara me afate të përcaktuara, synojnë përmbushjen e vizionit të Sistemit të Burgjeve.

Fig. 1 Prioritet e sektorëve sipas fushave të veprimit



Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve organizoi, menaxhoi dhe kontrolloi të gjitha institucionet penitenciare në varësi të saj. Gjatë vitit 2015 u menaxhuan **23** institucione penitenciare, prej të cilave një Institut për të Mitur në Kavajë, një Institut i Veçantë në Krujë dhe Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve. Numri i lartë i të burgosurve të trajtuar ka rritur dhe numrin e mbipopullimit në burgje dhe paraburgime. Për periudhën janar-dhjetor 2015, janë trajtuar mesatarisht **5882 të burgosur** në të gjitha IEVP, prej të cilëve 2920 të dënuar dhe 2962 të paraburgosur. Mbiopullimi ka qenë mesatarisht **22%**. Muajt e parë të vitit shënojnë numrin më të lartë të mbipopullimit me 27%-28%. Si rrjedhojë e vënies në funksion të dy institucioneve të reja në Fier dhe Berat, si dhe përfundimit të rikonstruksionit të IEVP Jordan Misja në Tiranë, kapacitetet e institucioneve u rritën nga 4537 në janar të vitit 2015 në 5484 në nëntor të 2015. Si rrjedhojë mbipopullimi në burgje në dhjetor të vitit 2015 shënoi një ulje me 13%.

Duke marrë në konsideratë rekomandimet e adresuara në Progres Raportin e Komisionit Evropian më datë 10 nëntor 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka hartuar një plan të integruar masash i cili do të sigurojë ndjekjen e duhur të gjetjeve dhe rekomandimeve të palës evropiane. Me Urdhrin Nr. 10427 datë 23.11.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve u miratua Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Progres Raportit të Komisionit Evropian, në të cilin janë reflektuar masat afatshkurtra për përmbushjen e rekomandimeve dhe menaxhimin e sfidave të ardhshme për Sistemin e Burgjeve. Në progres raport janë renditur një sërë çështjesh shqetësuese për Sistemin e Burgjeve,

përmirësimi i të cilave kërkon një bashkëpunimin dhe vendimmarrje ndërinstitucionale. Çështjet më të ndjeshme që adresoheshin për Sistemin e Burgjeve përfshinin:

- (1) Adresimi i rekomandimeve të Mekanizimit Kombëtar të Parandalimit të Torturës;
- (2) Eliminimi i rasteve të përdorimit disproporcional të forcës dhe dhunës nga policia e burgjeve. Denoncimi te organet kompetente;
- (3) Çështje të privatësisë dhe mungesa e konfidencialitetit të bisedave të burgosurve të dënuar duhet të trajtohen;
- (4) Masa të mëtjeshme për të siguruar trajtim të specializuar për të sëmurët mendor në të gjitha institucionet;
- (5) Masa të mëtjeshme për të përmirësuar kushtet e paraburgimit dhe adresimin e mbipopullimit në burgje dhe paraburgime;
- (6) Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve të vjetra dhe të ndërtuara së fundmi;
- (7) Sigurimi i qasjes në shërbimet e duhura shëndetësore, së bashku me standardet e higjienës dhe shëndetit;
- (8) Të burgosurit vazhdojnë të mbështeten nga familjet e tyre me ushqim, pajisje dhe medikamente;
- (9) Forcimi i rrjeteve mbështetëse para dhe pas lirimit të burgosurve për të mundësuar ri-integrimin e suksesshëm në shoqëri;
- (10) Vënia në praktikë e kurseve profesionale në burgje si pjesë e programeve të paralirimit;
- (11) Përmirësimi i kuadrit ligjor për pagesat e skemës së punësimit të burgosurve;
- (12) Mbiipopullimi mbetet ende problem;
- (13) Ngritja e një institucioni të specializuar për trajtimin e të sëmurëve mendor.

Në funksion të zbatimit të programeve të ri-integrimit për kategorinë e personave me liri të kufizuar pas lirimit të tyre, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka qenë aktive në ndërmarrjen e nismave të bashkëpunimit me institucioneve përgjegjëse dhe aktorëve aktivë në çështjet e ri-integrimit të personave në konflikt me ligjin. Pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në nëntor të vitit 2014, është rritur angazhimi për zbatimin e programeve të ri-integrimit fillimisht për kategoritë me nevoja më specifike për mbështetje, si të miturit dhe gratë.

ARRITJET KRYESORE

1. Reforma legjislative

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 437, datë 20.05.2015, u miratua Rregullorja e re e Përgjithshme e Burgjeve. Kjo rregullore vjen në përputhje me zhvillimet në sistemin e burgjeve si pjesë e reformës në drejtësi dhe garanton respektimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve për trajtimin e personave me liri të kufizuar duke vënë theksin te parimi i individualizimit. Parashikimi i rregullave të posaçme për trajtimin e grupeve vulnerabël në burgje, si dhe monitorimi, inspektimi dhe masat antikorrupsion përbëjnë nismat kryesore në rregulloren e re të miratuar.

2. Hartohet programi i transparencës i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

Me urdhrin Nr. 3457/2 Prot. datë 04.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm u miratua programi i transparencës i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 119/2014, DPB ka përgatitur programin e transparencës. Informacioni i bërë publik në programin e transparencës nëpërmjet pasqyrimit të detajuar në faqen zyrtare online të DPB-së, www.dpbsh.gov.al, si dhe në zyrën e pritjes së qytetarëve, synon krijimin e një sistemi të hapur për marrjen e informacionit dhe të dhënave që administron Sistemi i Burgjeve, në përputhje me parashikimet ligjore. Transparenca për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është përkthyer në termat e dymë të hapura për informacion, takime me grupet e interesit, marrëdhënie efikente dhe dobiprurëse me publikun, website me informacion të azhurnuar në kohë reale, publikime periodike të raporteve me të dhëna mbi respektimin e të drejtave të personave me liri të kufizuar.

3. Modeli 4x4 për mbledhjen e informacionit për sigurinë në burgje

Bazuar në eksperiencën dhe përvojën e suksesshme të sistemit anglez në menaxhimin e sigurisë, ka filluar zbatimin e modelit anglez 4x4 në Sistemin e Burgjeve Shqiptare. Faza e parë është testimi dhe pilotimi në burgun e sigurisë së lartë në Fushë Krujë me qëllim parandalimin dhe zbulimin e krimit për të reaguar ndaj kërcënimeve të sigurisë, parandalimin e incidenteve, si dhe menaxhimin e tyre. Me testimin e këtij modeli në burgun e Fushë Krujës do të fillojë zbatimin në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Modeli 4x4 ose Raporti Informativ mbi Sigurinë do të analizojë informacionin mbi sigurinë. Rezultate të pritshme nga ky model janë zhvillimi i strategjive për të neutralizuar kërcënimet ndaj interesave kombëtare dhe sigurisë së institucioneve, të ndihmojë në mbarëvajtjen e rregullit dhe kontrollit, si dhe parandalimin dhe zbulimin e krimit. Me Urdhrin Nr. 7927, datë 10.09.2015, u miratua formati standard i raportit informativ mbi sigurinë për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave të sigurisë. Formulari standard për Raportin Informativ mbi Sigurinë ka për qëllim analizimin e informacionit mbi sigurinë, të ndihmojë në parandalimin dhe administrimin e incidenteve, zhvillimin e strategjive për neutralizimin e kërcënimeve ndaj sigurisë, mbarëvajtjen e rregullit dhe kontrollit, si dhe të ndihmojë në parandalimin dhe zbulimin e krimit.

4. Projekt binjakëzimi për reformën në Sistemin e Burgjeve dhe Shërbimin e Provës

Me mbështetjen financiare të delegacionit të Bashkimit Evropian në muajin dhjetor 2015 filloi aplikimin e projektit të binjakëzimit për reformën në sistemin e burgjeve, në të cilin janë përcaktuar gjashtë shtylla kryesore: 1. Përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore sipas *acquis communautaire*; 2. Ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve; 3. Menaxhimi i të burgosurve me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe grupeve vulnerabël; 4. Krijimi i një sistemi të pavarur inspektimi dhe monitorimi për burgjet; 5. Platformë e integruar për komunikimin me publikun; 6. Forcimi i zbatimit të dënimeve alternative.

5. Miratohet Rregullorja e Etikës së Policisë së Burgjeve

Me Urdhrin Nr. 10288, datë 18.11.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm u miratua Rregullorja e Etikës së Policisë së Burgjeve. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave standarde profesionale të sjelljes gjatë ushtrimit të detyrave profesionale të stafit me uniformë në Sistemin e Burgjeve. Ky kod ofron udhëzime si dhe përcakton parimet bazë të sjelljes profesionale të punonjësve të policisë së burgjeve bazuar në dispozitat ligjore,

si dhe standardet gjithëpërfshirëse të etikës dhe komunikimit. Në kuptim të kësaj rregulloreje Kodi i Etikës është tërësia e parimeve dhe normave mbi bazën e të cilave punonjësit e të gjitha niveleve të policisë së burgjeve në Republikën e Shqipërisë shprehin vullnetin e tyre dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe zbatimin e ligjit, duke u karakterizuar nga humanizmi, objektiviteti dhe sjellja e kulturuar gjatë përmbushjes së detyrave.

6. Ngrihet Komiteti i Sigurisë në Burgje

Me Urdhrin Nr. 11383, datë 22.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve u ngrit Komiteti i Sigurisë në IEVP. Komiteti ka qëllim kryesor shqyrtimin, evidentimin dhe marrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e ngjarjeve që cenojnë sigurinë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, analizimin e risqeve kryesore, adresimin e masave të menjëhershme për zgjidhjen e tyre, vlerësimin e nivelit të risqeve sipas shkallës së vlerësimit 5x5, si dhe diskutimin e njohjen me risqet relevante të rreziqeve të pranishëm. Komiteti i Sigurisë do të ketë këto detyra: Shqyrtimi i çështjeve ekzistuese të sigurisë; Shqyrtimi i raporteve të sigurisë dhe trajtimi i çështjeve të evidentuara; Klasifikimi i çështjeve kryesore, hartimi dhe përditësimi i një liste të veçantë për ndjekjen e këtyre çështjeve; Evidentimi i masave që do të merren për zgjidhjen e çështjeve të adresuara; Përcaktimi i çështjeve dhe objektivave të sigurisë për muajin e ardhshëm; Evidentimi i risqeve kryesore.

7. Plan masash për sigurinë në IEVP dhe përmirësimin e punës dhe shërbimit

Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale iu janë caktuar detyra konkrete lidhur me hartimin e planit të masave për forcimin e sistemit të sigurisë dhe rritjen e kapaciteteve e aftësive të stafit gjatë zbatimit të detyrave funksionale dhe shërbimit të policisë. Me qëllim garantimin e rendit dhe sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave funksionale në zbatim të akteve ligjore e nënligjore ndër të tjera janë lënë këto detyra: 1. Të ushtrohen kontrole për zbatimin e urdhrave, udhëzimeve për kryerjen e aktivitetit me të paraburgosurit dhe dënuarit, për kryerjen e shërbimeve, për gjendjen e elementeve të sigurisë në regjimet e brendshme dhe të jashtëm, për garantimin e rendit e sigurisë dhe parandalimin e ngjarjeve, duke raportuar me përgjegjësi problemet që konstatohen dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre. 2. Të kryhen instruksione të posaçme me punonjësit e Policisë së Burgjeve, mbi detyrat për kryerjen e shërbimit, mbi zbatimin e kërkesave gjatë kontrolleve fizike para futjes në regjimet e brendshme të materialeve të punonjësve me uniformë, civilë dhe personave të tjerë. 3. Të monitorohet aktiviteti ditor me të dënuarit e paraburgosurit, duke kërkuar zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për garantimin e sigurisë dhe parandalimin e ngjarjeve, bazuar në Ligjin Nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, neni 11/1/2/7, në rregullore, urdhra dhe udhëzimet e dërguara. 4. Të ushtrohen kontrole për njohjen e rregullave të sigurimit teknik dhe përdorimin e armatimit, nga punonjësit e policisë, sipas kërkesave të rregullores, për të parandaluar çdo premisë për ngjarje. 5. Të ushtrohen kontrole për disiplinën, paraqitjen e jashtme dhe mënyrën e komunikimit të punonjësve të policisë me qytetarët, kolegët, vartësit, eprrorët, paraburgosurit dhe të dënuarit.

8. Inaugurohet dhoma e takimeve të miturve me familjarët

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Save the Children inauguruan ambientet e reja të takimeve të miturve me familjarët e tyre. Gjatë vitit 2015 u ndërmor një nismë e rëndësishme që kishte për qëllim forcimin e marrëdhënieve të personave me liri të kufizuar me familjarët e tyre. Kjo nismë u jetësua përmes zbatimit të programit “Prindërimi në distancë”, i cili konsistoi në përshtatjen e ambienteve të takimit të personave të dënuar dhe të paraburgosur me familjarët e tyre. Pjesë e kësaj nisme ishte gjithashtu përshtatja e një ambienti të ri takimesh të miturve në Institutin e të Miturve në Kavajë me familjarët e tyre, i cili synonte krijimin e një atmosfere sa më miqësore. Kjo projekt-ide e DPB-së, u mbështet financiarisht nga organizata Save the Children, e cila prej vitit 2010 zbaton në Institutin e të Miturve Kavajë programin “Fuqizimi i sistemit të drejtësisë për të miturit”.

9. Miratohet plani i inspektimeve të Bordit Antikorrupsion

Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Mbi ngritjen e Bordit Antikorrupsion në Sistemin Penitenciar” dhe planin e 600 ditëve të dyta të qeverisë, me Memon nr. 155, datë 07.08.2015 u miratua plani i inspektimeve të bordit për një periudhë 3-mujore. Plan i inspektimeve përfshiu disa IEVPenale, të cilat kanë potencial për përfshirje në akte korruptive bazuar në disa tregues, si ankesat e marra në rrugë telefonike (numri pa pagesë), rrugë elektronike (e-maili zyrtar i DPB), kërkesë- ankesat e familjarëve, mbipopullimi e faktorë të tjerë. Institucionet të cilat u bënë pjesë e inspektimeve gjatë fazës së parë ishin IEVP Peqin, Rrogozhinë, Krujë, Sarandë, Tepelenë, Vlorë dhe Korçë. Fokusi i inspektimeve përfshinte verifikimin e dokumentacionit të lejeve shpërblyese dhe të veçanta, vlerësimet e sjelljes së të dënuarve dhe dosjen e të burgosurve, rregullsia e punësimit të burgosurve sipas skemës së punës, zbatueshmëria ligjore, verifikimi i dokumentacionit të pranimit të të burgosurve, ushqimi, veprimet financiare etj.

10. Dokument politikash për grupet vulnerabël. Me urdhrin nr. 3949 datë 05.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm, u miratua dokumenti i politikave për grupet vulnerabël në sistemin e burgjeve. Dokumenti i politikave artikulon rolin e sistemit të burgjeve në maksimizimin dhe promovimin e zhvillimit social të kategorive vulnerabël në sistemin e burgjeve. Ky dokument ofron një qasje proaktive me qëllim vlerësimin e risqeve për marginalizim dhe planifikimin e masave për minimizimin e tyre. Dokumenti i politikave synon integrimin e shërbimeve për këto grupe vulnerabël, mbështetur në parimin e përshtatjes së arsyeshme, sipas nevojave për çdo kategori.

11. Hartimi i Rregullores së Administrimit të Dhënave të Gjendjes Gjyqësore

Me urdhrin nr. 28, datë 29.01.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është miratuar Rregullorja e Administrimit të të Dhënave të Gjendjes Gjyqësore. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe kërkesave për administrimin e bazës së të dhënave të programit të zyrës së Gjendjes Gjyqësore, të përcaktojë rregullat për një zbatim efikas të ligjit Nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”, si dhe ligjit Nr. 9614, datë 21.09.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”. Në rregullore janë përcaktuar rregullat e administrimit të përdoruesve, rregullat për sigurinë fizike dhe aksesimin e serverave, procedurat e realizimit të backup dhe restore të bazës

së të dhënave, procedurat për instalimet e update apo upgrade e bazës së të dhënave, si dhe rregullat e administrimit të fjalëkalimeve.

12. Përmirësimi i formatit të dosjes psiko-sociale

Kjo dosje vjen në përputhje me rekomandimet e organizatave monitoruese për përmirësimin e dosjes në funksion të praktikitetit, transparencës së punës trajtuese dhe ndërhyrëse, që bëhet në bashkëpunim me të dënuarin/të paraburgosurin, për një rehabilitim të shpejtë dhe ri-integrim të suksesshëm në shoqëri. Informacioni që do të grumbullohet gjatë gjithë qëndrimit të personit në institucionet penitenciare do të shërbejë për administrimin e një sistemi database elektronik të dhënash individuale dhe të klasifikuara për të dënuarit/të paraburgosurit. Të dhënat e këtij sistemi do të shërbejnë për shkëmbimin e informacionit në kohë reale me institucione të tjera të përfshira në sistemin e Drejtësisë Penale, apo që lehtësojnë procesin e ri-integrimit, kryerjen e studimeve të përbashkëta në fusha specifike të lidhura me kriminalitetin dhe parandalimin, të cilat do të mund të shërbejnë për orientimin e politikave penale në të ardhmen.

13. Seminar pune me ekspertë të Këshillit të Evropës

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës më 25- 26 maj 2015 u organizua takimi i stafit multidisiplinar me përfaqësues të gjitha institucioneve penale me temë “Kushtet dhe trajtimi i të burgosurve në Shqipëri”. I konceptuar në formën e një sesiioni të hapur diskutimi dhe ndarje të eksperiencave pozitive, ekspertët e Këshillit të Evropës prezantuan disa parime dhe praktika të vendeve të tyre, të cilat përfshinin: standardet e Këshillit të Evropës dhe Komitetit të Parandalimit të Torturës; menaxhimin e të burgosurve me dënime të gjata dhe të përjetshëm; vendosjen në izolim si dënim disiplinor; forcimin e sigurisë nëpërmjet marrëdhënieve konstruktive ndërmjet stafit dhe të burgosurve; garantimin e mbrojtjes nga keqtrajtimi, ankesat e të burgosurve, inspektimi i brendshëm dhe monitorimi i pavarur. Referuar praktikave të vendeve përfaqësuese të ekspertëve të Këshillit të Evropës dhe programeve rehabilituese që aplikoheshin në sistemet e tyre, u panë me interes të veçantë disa modele të menaxhimit dhe instrumenteve për matjen e klimës në institucion, të cilat janë të nevojshme për tu aplikuar edhe në sistemin shqiptar.

14. Hartimi i një praktike të re bashkëkohore për administrimin e bibliotekave në IEVP

Aksesi në biblioteka i personave me liri të kufizuar është një aspekt i rëndësishëm në procesin e rehabilitimit. Si i tillë, ka filluar angazhimi për përmirësimin e gjendjes aktuale të bibliotekave, si dhe praktikën dokumentare të administrimit të tyre. Është komunikuar me shtëpi botuese, të cilat janë të interesuara të mbështesin DPB me disa tituj librash. Në funksion të përmirësimit të procesit të administrimit të bibliotekave në IEVP, është miratuar udhëzuesi për administrimin e bibliotekave me formatet përkatëse (nr. 1526 Prot. datë 20.02.2015).

15. Aplikohet formulari standard për listën e shërbimeve të ofruara nga DPB

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 27.05.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 693, datë 22.10.2014, “Për krijimin e Qendrës së Ofrimit

të Shërbimeve Publike të Integruara”; Udhëzimin Nr. 3477 datë 22.07.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për metodologjinë e klasifikimit, kodifikimit dhe formularët e aplikimit të shërbimeve që ofrohen nga administrata shtetëror, me Urdhrin Nr. 7209/1, datë 04.09.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm u vunë në zbatim Formularët Standardë për Listën e Shërbimeve të Ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Shërbimet e përcaktuara sipas Udhëzimit Nr. 3477 datë 22.07.2015 dhe për të cilat është hartuar një formular standard janë: 1. Vërtetim për kohën e kryerjes së dënimit për ish- të burgosurit politikë; 2. Formular aplikimi për pajisje me certifikatë të gjendjes gjyqësore.

16. Aplikimi i një projekti në IEVP “Ali Demi” dhe IMKavajë mbi artin e kulinarisë në kushtet e burgut

Përmirësimi i shërbimeve nëpërmjet aplikimit të terapive mbi artin, ka qenë vazhdimisht në fokus të punës rehabilituese për personat me liri të kufizuar. Projekti i ri synon jo vetëm përmirësimin e shërbimit të kuzhinës në dy IEVP, por edhe përfshirjen e grave dhe të miturve të dënuar në praktikimin e gatimit si një formë terapie okupacionale. Projekti ka filluar të zbatohet dhe do të shtrihet përgjatë muajve Shkurt-Mars 2015. Në vijim të vizitave dhe kontakteve fillimisht në IEVP “Ali Demi”, është hartuar një menu e re ushqimore, e cila rrit llojshmërinë e gatimeve brenda normativës ushqimore të miratuar për IEVP. Implementimi i kësaj menuje po pilotohet në këtë institucion.

17. Tryezë pune mbi recidivizmin

Një tryezë pune me fokus recidivizmin u mbajt me pjesëmarrjen e përfaqësuesve më të lartë të institucioneve qeveritare, të cilat përballen në një formë të caktuar me fenomenin e recidivizmit apo përsëritjes së krimeve. I konceptuar si një tryezë pune me dy sesione dhe me dy panele të ftuarish, takimi krijoi diskutimin shumëpalësh të ideve dhe mundësive të zgjidhjes së problematikave që hasen aktualisht tek trajtimi i të miturve në kontakt dhe në konflikt me ligjin, burgosjen e tyre në mungesë të një instituti riedukimi, rehabilitimin dhe rikthimin në veprat penale të njëjta apo të ndryshme, pra përfshirjen në veprimtari kriminale etj. Të gjitha diskutimet u përqendruan tek gjetja e mënyrave dhe ngritja e mekanizmave të duhura për të çuar në zgjidhjen e përhershme të fenomenit të recidivizmit tek të miturit. Ky aktivitet u bë i mundur me mbështetjen e organizatës “Save the Children”, e cila prej vitesh punon në fushën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, sidomos në trajtimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin.

18. Çelet ekspozita me punimet artistike dhe artizanale të të burgosurve në Galerinë Kombëtare të Arteve

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Galerinë Kombëtare të Arteve dhe mbështetjen e Bankës Veneto çelën një ekspozitë unike me punimet artistike dhe artizanale të burgosurve nga e gjithë Shqipëria. Ekspozita nën titullin domethënës “Edukimi përmes artit” është një risi në llojin e vet, pasi kjo është hera e parë që personat me liri të kufizuar ekspozojnë punimet e tyre në një institucion kombëtar të kësaj rëndësie, siç është Galeria Kombëtare e Arteve.

19. Certifikohen 40 të paraburgosur mbi guidat turistike

Në IEVP Vaqarr u zhvillua ceremonia e certifikimit të burgosurve që kanë ndjekur kursin profesional "Guidë Turistike", të mundësuar nga bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional nr. 4, Tiranë. Kursi profesional ishte me interes për të paraburgosurit, të cilët patën mundësinë jo vetëm të angazhohen dhe motivohen gjatë qëndrimit në IEVP, por edhe të zhvillojnë interesat e tyre në fushën e turizmit. Kjo nismë është një mundësi shumë e mirë për t'i parapërgatitur për tregun e punës menjëherë pas lirimit. Kursi u zhvillua gjatë periudhës mars-qershor 2015, me pjesëmarrjen e dy grupeve të paraburgosurish me një total prej 40 personash.

20. Trajnim trajnerësh të sistemit të burgjeve në bashkëpunim me OSBE, ICTAP dhe Policinë e Shtetit

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe ICITAP organizuan ceremoninë e certifikimit për trajnim trajnerësh në sistemin penitenciar. Trajnimi i cili u shtri përgjatë dy javëve, nga data 23 qershor deri në 3 korrik, përfshiu pjesëmarrjen e 16 të trajnuarve dhe 6 trajnerëve (instruktorë) të sistemit të burgjeve dhe policisë së shtetit, që dhanë njohuri për punonjësit e përzgjedhur nga stafet e burgjeve të gjithë Shqipërisë. Mjekë, punonjës socialë, juristë, punonjës të sigurisë së burgjeve ishin bashkuar në këtë program, i cili është i dyti në llojin e tij që po zbatohet në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me mbështetjen e dy organizatave ndërkombëtare të rëndësishme në vendin tonë, siç janë OSBE dhe ICITAP. Trajnimet kishin në fokus zhvillimin e aftësive pedagogjike, të drejtimit të institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale, të dhënies së njohurive mbi tema të rëndësishme që janë pjesë e punës së përditshme në këtë sistem.

PROBLEMATIKAT KRYESORE

1. Mungesa e investimeve dhe fondeve për përmirësimin e elementëve të sigurisë:

Mungesa e investimeve, për blerjen e pajisjeve të kontrollit (skaner, detektor metal kërkues) etj, e cila ndikon ndjeshëm në realizimin e monitorimit dhe kontrollit të hyrje-daljeve nga rajonet e banimit të dënuarve. Problem themelor mbetet mungesa e fondeve për të përmirësuar elementët e sigurisë, të cilët me kalimin e viteve amortizohen dhe kanë nevojë për ndërhyrje të herë pas hershme. Kërkesat dhe planet e masave për ndërhyrje nuk zbatohen sipas standardeve të kërkuara dhe objektivave SMART.

2. Mbipopullimi në IEVP

Ky fenomen detyrimisht sjell pasoja në drejtim të reduktimit të kohës së ajrimit, kohës së takimit me të afërmit, të trajtimit individual të paraburgosurve nga ana e punonjësve të kujdesit social, ligjor etj. Mbiipopullimi sjell pasoja edhe në drejtim të transferimit të dënuarve nga paraburgimet dhe komisaritet në institucione me pak të mbipopulluara larg vendbanimit të familjarëve të tyre. Edhe pse krahasuar me vitin 2014 ka pasur një ulje minimale me 2%, mbiipopullimi në burgje ka qenë në vëmendje të disa institucioneve monitoruese duke e përcaktuar si faktor të qenësishëm për standardet në të cilat mbahen dhe trajtohen personat me liri të kufizuar, por edhe si element për përfshirjen në akte korruptive të punonjësve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara. Mbiipopullimi gjatë vitit 2015 ka qenë mesatarisht 22% krahasuar me 24% në vitin 2014. Krahasuar me një bazë 5-vjeçare dy vitet e fundit kanë shënuar nivelin më të lartë të mbiipopullimit të cilat kanë

rritur nivelin e vështirësisë për menaxhimin me efektivitet të institucioneve penitenciare dhe zbatimin e parashikimeve ligjore për strehimin dhe akomodimin e personave me liri të kufizuar.

3. Mungesa e investimeve për pajisje dhe uniforma policie

Mungesa e investimeve për blerjen e pajisjeve të kontrollit (skaner, dedektor metal kërkues) etj, ndikon ndjeshëm në realizimin e monitorimit e kontrollit të hyrje-daljeve nga rajonet e banimit të dënuarve. Mungesa e fondeve për mjetet e transportit ë burgosurve. Mjetet aktuale ne dispozicion janë të amortizuara. Gjithashtu, mbetet faktorë pengues mungesa e uniformave për punonjësit e Policisë së Burgjeve.

4. Trajtimi i personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “mjekim i përkohshëm i detyruar”

Personat me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer një vepër penale dhe janë dënuar nga gjykata të vuajnë dënimin në institucione psikiatrike, mbahen në burgje, përkatësisht I EVP Krujë dhe Institutin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve. Bazuar në dispozitat ligjore kjo kategori nuk duhet të akomodohet në institucionet penale, sepse këto institucione nuk posedojnë infrastrukturën e duhur dhe resurset njerëzore të trajnuara, të specializuara për trajtimin specifik që e ka të nevojshëm ky kontingjent.

REALIZIMI I PLANIT TË 600 DITËVE TË DYTA TË QEVERISJES

Në zbatim të politikave të Qeverisë Shqiptare dhe objektivat e Ministrisë së Drejtësisë për Sistemin e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve hartoi planin e 600 ditëve të dyta të punës. Në plan u përcaktuan produktet kryesore që do të realizoheshin gjatë vitit 2015, si dhe u përcaktuan modalitetet e nevojshme për arritjen e angazhimeve të ndërmarra. Plani i punës ka qenë objekt raportimi çdo javë nga strukturat përkatëse.

Qëllimi A: Reformimi i Sistemit të Burgjeve bazuar në standardet ndërkombëtare të trajtimit të personave me liri të kufizuar dhe nivelit të siguriës.

Për realizimin e këtij qëllimi u specifikua 1 objektiv kryesor, si dhe 4 produkte të pritshme për tu realizuar gjatë vitit 2015. Gjithashtu, u planifikuan 20 aktivitete për realizimin e produkteve.

Produkti 1: Model 4x4 për sigurimin e informacionit në burgje i hartuar dhe zbatuar. Realizuar në masën 100%.

Bazuar në eksperiencën dhe përvojën e suksesshme të sistemit anglez në menaxhimin e siguriës, ka filluar zbatimi i modelit anglez 4x4 në Sistemin e Burgjeve Shqiptare. Faza e parë është testimi dhe pilotimi në burgun e siguriës së lartë në Fushë Krujë me qëllim parandalimin dhe zbulimin e krimit për të reaguar ndaj kërcënimeve të siguriës, parandalimin e incidenteve, si dhe menaxhimin e tyre. Me testimin e këtij modeli në burgun e Fushë Krujës do të fillojë zbatimi në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Modeli 4x4 ose Raporti Informativ mbi Sigurinë do të analizojë informacionin mbi sigurinë. Rezultate të pritshme nga ky model janë zhvillimi i strategjive për të neutralizuar kërcënimet ndaj interesave kombëtare dhe siguriës së institucioneve, të ndihmojë në mbarëvajtjen e rregullit dhe kontrollit, si dhe parandalimin

dhe zbulimin e krimit. Me Urdhrin Nr. 7927 datë 10.09.2015 u miratua formati standard i raportit informativ mbi sigurinë për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave të sigurisë. Formulari standard për Raportin Informativ mbi Sigurinë ka për qëllim analizimin e informacionit mbi sigurinë, të ndihmojë në parandalimin dhe administrimin e incidenteve, zhvillimin e strategjive për neutralizimin e kërcënimeve ndaj sigurisë, mbarëvajtjen e rregullit dhe kontrollit, si dhe të ndihmojë në parandalimin dhe zbulimin e krimit. Gjithashtu, u përcaktua një person i cili do të administrojë të gjithë procesin. Stafi i IEVP Fushë Krujë u trajnua në lidhje me administrimin e të gjithë procesit. Sistemi u vë në funksion të plotë gjatë muajit tetor 2015. Bazuar në informacionet e përfituara nga raportet u morën një sërë masash nga IEVP Fushë Krujë, si inspektime të befasishme, bashkëpunim me Komisariatën e Policisë së Rrethit dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Burgje, dërgim për procedim penal i punonjësve të policisë së përfshirë në tentativë për futjen e sendeve të ndaluara në IEVP.

Produkti 2: Rregullore e Brendshme për Kodin e Etikës dhe Disiplinës. Realizuar në masën 100%.

Me Urdhrin Nr. 10288 datë 18.11.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm u miratua Rregullorja e Etikës së Policisë së Burgjeve. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave standarde profesionale të sjelljes gjatë ushtrimit të detyrave profesionale të stafit me uniformë në Sistemin e Burgjeve. Ky kod ofron udhëzime, si dhe përcakton parimet bazë të sjelljes profesionale të punonjësve të policisë së burgjeve bazuar në dispozitat ligjore, si dhe standardet gjithëpërfshirëse të etikës dhe komunikimit. Në kuptim të kësaj rregulloreje Kodi i Etikës është tërësia e parimeve dhe normave mbi bazën e të cilave punonjësit e të gjitha niveleve të policisë së burgjeve në Republikën e Shqipërisë shprehin vullnetin e tyre dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe zbatimin e ligjit, duke u karakterizuar nga humanizmi, objektiviteti dhe sjellja e kulturuar gjatë përmbushjes së detyrave.

Produkti 3: Raport vlerësues për aplikimin e zbatimit të burgjeve me regjim të hapur.

Janë realizuar në masën 100% aktivitetet e planifikuara për vitin 2015 në lidhje me këtë produkt. Janë propozuar dhe miratuar ndryshimet në legjislacion për krijimin e regjimeve të hapura në IEVP. Qëllimi kryesor i regjimeve të hapura në institucionet penitenciare është forcimi i sistemit të rehabilitimit social të personave me liri të kufizuar, komunikimin me botën e jashtme, si dhe organizimin e brendshëm strukturor duke synuar forcimin e sigurisë dhe raport standard staf i burgosur.

Produkti 4: Sistem për sigurimin e nevojave të grupeve vulnerabël në burgje (përfshirë të sëmurët mendor). Realizuar në masën 100%.

Me urdhrin nr. 3949 datë 05.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm, u miratua dokumenti i politikave për grupet vulnerabël në sistemin e burgjeve. Dokumenti i politikave artikulon rolin e sistemit të burgjeve në maksimizimin dhe promovimin e zhvillimit social të kategorive vulnerabël në sistemin e burgjeve. Ky dokument ofron një qasje proaktive me qëllim vlerësimin e risqeve për marginalizim dhe planifikimin e masave për minimizimin e tyre. Dokumenti i politikave synon integrimin e shërbimeve për këto grupe vulnerabël, mbështetur në parimin e përshtatjes së arsyeshme, sipas nevojave për çdo kategori.

Në zbatim të Dokumentit të Politikave për grupet vulnerabël në sistemin e burgjeve dhe Planit të Veprimit, janë përcaktuar treguesit për evidentimin e nevojave të grupeve vulnerabël dhe janë hartuar formatet respektive për administrimin e të dhënave për çdo kategori të personave të paraburgosur apo të dënuar. Ky sistem do të forcohet më tej, si komponent i rëndësishëm i projektit të binjakëzimit për sistemin penitenciar dhe shërbimin e provës, të financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Qëllimi B: Të forcojë sistemin e rehabilitimit dhe ri-integrimit social për personat me liri të kufizuar.

Për realizimin e këtij qëllimi u specifikua 1 objektiv kryesor, si dhe 6 produkte të pritshme për tu realizuar gjatë vitit 2015. Gjithashtu, u planifikuan 25 aktivitete për realizimin e produkteve.

Produkti 5: Dokument dhe Plan Veprimi për trajtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar në sistemin e burgjeve. Realizuar në masën 100%.

Me Urdhrin Nr. 9007 datë 12.10.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm u miratua dokumenti i politikave që do të zbatohet në Sistemin e Burgjeve për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar. Qëllim i dokumentit është krijimi i politikave të zbatueshme, duke pasur parasysh kushtet aktuale të infrastrukturës në burgje, e cila përbën pengesën më të madhe për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën e përditshme në kushtet e izolimit, si dhe në pjesëmarrjen e tyre në programet rehabilituese për arsimim, punësim dhe formim profesional. Çështje themelore të dokumentit përfshijnë: a. Inkurajimi dhe edukimi për një mjedis social që mundëson pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara; b. Sigurimi i arsimit optimal për personat me aftësi të kufizuara; c. Sigurimi i mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik për personat me aftësi të kufizuara; d. Promovimi i një shërbimi publik të përgjegjshëm dhe transparent ndaj personave me aftësi të kufizuar; e. Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara për një jetë cilësore kushtet e izolimit; f. Mbledhja dhe përdorimi i informacionit lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe çështjet e Aftësisë së Kufizuar. Dokumenti shoqërohet me një plan veprimi dhe aktivitete konkrete për realizimin e çdo mase të parashikuar sipas afateve kohore. Struktura përgjegjëse në drejtorinë e burgjeve do të monitorojë zbatimin e planit në institucionet e varësisë. Dokumenti i Politikave të Personave me Aftësi të Kufizuara në sistemin e burgjeve, dhe Plani i Veprimit, adreson masa për përmirësimin e statusit shëndetësor dhe cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me Standardet e OKB mbi Mundësitë e Barabarta.

Produkti 5: Modul i rehabilitimit social për personat me vite të gjata dënimi apo me dënim të përjetshëm. Realizuar në masën 100%.

Në zbatim të Planit të 600 ditëve të Drejtorisë së Burgjeve u miratua manuali për trajtimin e personave me vite të gjata dënimi ose burgim të përjetshëm, urdhri nr. 9978 datë 09.11.2015 i Drejtorit të Përgjithshëm. Programi për personat me vite të gjata dënimi apo burgim të përjetshëm, mbështetet në ofrimin e shërbimeve individuale dhe në grup, për këtë kategori të dënuarish, shërbime që adresojnë aspekte kriminogjene, si: abuzimi me substancat, të menduarit kriminal, menaxhimin e agresivitetit, marrëdhëniet me familjen, përshtatja ndaj ndryshimit, ndikimi tek viktimat etj. Kohëzgjatja e programit varion

mbështetur në vlerësimin e nevojave individuale. Jetesa e gjatë në burgje nuk ofron mundësi jashtë mureve të burgut, nuk ofron përshtatje me zhvillimet e reja të shoqërisë, nuk ofron shpresë. Kjo krijon vështirësi veçanërisht për të miturit dhe të rinjtë. Maturimi për ta mund të çojë në atë që konsiderohet reflektim, që është themeli për ndërgjegjësimin, pendesën dhe rehabilitimin në këtë grup-moshë. Ndodh që kjo kategori të mos jetë e përfshirë në programet rehabilituese në burgje kjo jo vetëm për shkak të mos interesimit nga ana e tyre, por edhe për faktin e mungesës së programeve specifike apo ndërmarrjes së politikave konkrete, të cilat mund të nxisin angazhimin e të dënuarve dhe orientojnë përmbushjen e nevojave kryesore që evidentohet.

Sa më sipër, u hartua ky manual për një punë sistematike për rehabilitimin e personave me liri të kufizuar me vite të gjata dënimi. Programi për personat me vite të gjata dënimi apo burgim të përjetshëm, mbështetet në ofrimin e shërbimeve individuale dhe në grup, për këtë kategori të dënuarish, shërbime që adresojnë aspekte kriminogjene, si: abuzimi me substancat, të menduarit kriminal, menaxhimin e agresivitetit, marrëdhëniet me familjen, përshtatja ndaj ndryshimit, ndikimi tek viktimat etj..

Produkti 6: Projekt mbi integrimin social të personave në konflikt me ligjin të pakicave etnike-kulturore i hartuar. Realizuar në masën 100%.

Në zbatim të dokumentit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, mbi zbatimin e projekteve të përbashkëta, që synojnë nxitjen e reformave të sistemit penitenciar, plotësimin e standardeve për trajnimin me dinjitet të personave në konflikt me ligjin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore për këto kategori personash, në bashkëpunim me organizatën MERIDIA është hartuar një projekt mbi integrimin social të miturve në konflikt me ligjin, që iu përkasin pakicave etnike-kulturore.

Produkti 7: Praktikë e re bashkëkohore për administrimin e bibliotekave në IEVP. Realizuar në masën 100%.

Në funksion të standardizimit dhe unifikimit të praktikave të administrimit të bibliotekave në IEVP, është hartuar një praktikë bashkëkohore, e cila ka përmirësuar dukshëm funksionimin e bibliotekave dhe miradministrimin e tyre. Aksesin në biblioteka i personave me liri të kufizuar është një aspekt i rëndësishëm në procesin e rehabilitimit. Si i tillë, filloi angazhimi për përmirësimin e gjendjes aktuale të bibliotekave, si dhe praktikën dokumentare të administrimit të tyre. U komunikua me shtëpi botuese, të cilat mbështetën DPB me disa tituj librash. Në funksion të përmirësimit të procesit të administrimit të bibliotekave në IEVP, është miratuar udhëzuesi për administrimin e bibliotekave me formatet përkatëse (nr. 1526 Prot. datë 20.02.2015).

Produkti 8: Fushatë për dhurimin e librave për personat me liri të kufizuar nën moton “Dhuro një libër, bëj një mik”. Realizuar në masën 100%.

Projekti “Dhuro një libër, bëj një mik”, nisi si një nismë e të miturve të paraburgosur dhe të dënuar në Institutin e të Miturve në Kavajë, si një ftesë drejtuar bashkëmoshatarëve të tyre, që të përdorin librin si mjet komunikimi nga jashtë, brenda burgut për të ruajtur kontaktet me botën e lirë dhe për më shumë shpresë për të ardhmen e tyre. Ftesës përmes kësaj fletëpalosje, për dhurimin e një libri për këta të mitur me një dedikim personal, iu përgjigjen shumë individë. Nga kjo iniciativë janë mbledhur 300 libra.

Produkti 9: Studim mbi kriminalitetin dhe recidivizmin tek kategoria e të miturve. Realizuar në masën 100%.

Studimi i kriminalitetit të miturve në Shqipëri, fokusuar kryesisht në faktorët psiko-socialë që ndikojnë në nxitjen e fenomenit në fjalë, është një përpjekje për të analizuar në disa dimensione situatën aktuale të të miturve në konflikt me ligjin. Rezultatet e këtij studimi janë me interes për të gjithë subjektet e interesuara për këtë kategori dhe veçanërisht për hartimin e politikave të parandalimit të kriminalitetit dhe rehabilitimit të të miturve që janë përfshirë në kryerjen e veprave penale. Qëllimi kryesor i punës së kryer në këtë drejtim është identifikimi dhe analizimi i faktorëve që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo indirekte në përfshirjen e të miturve në kryerjen e veprave penale.

Së pari, studimi përpiket të japë një tablo të qartë të krimeve të kryera nga të miturit, sipas statistikave që disponojnë strukturat shtetërore të publikuara në studime dhe raporte mbi situatën e të miturve në konflikt me ligjin. Së dyti, përmes shqyrtimit të literaturës së fushës, intervistave të kryera me të mitur të akuzuar apo dënuar për kryerjen e veprave penale, studimit të rasteve në terren dhe intervistave të realizuara me stafin e kujdesit social dhe atë të sigurisë në burgje dhe paraburgime, ky studim përpiket të hedhë dritë mbi faktorët psiko-socialë që ndikojnë më së shumti në përfshirjen e të miturve në vepra penale. Së treti, studimi parashtron disa strategji parandalimi si dhe pasqyron punën që realizohet aktualisht në burgje dhe paraburgime për rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri.

Produkti 10: Strategji dhe Plan Veprimi, për masa specifike për trajtimin e grupeve vulnerabël në Sistemin e Burgjeve. Realizuar në masën 100%.

Dokumenti i politikave artikulon rolin e sistemit të burgjeve në maksimizimin dhe promovimin e zhvillimit social të kategorive vulnerabël në sistemin e burgjeve. Ky dokument ofron një qasje proaktive me qëllim vlerësimin e risqeve për marginalizim dhe planifikimin e masave për minimizimin e tyre. Dokumenti i politikave synon integrimin e shërbimeve për grupet vulnerabël, mbështetur në parimin e përshtatjes së arsyeshme, sipas nevojave për çdo kategori. Qëllimi është përmirësimi i kushteve për të burgosurit e grupeve vulnerabël në aspekt të kushteve fizike, shëndetësore dhe sociale dhe krijimi i mundësive për punësim dhe formim profesional gjatë dhe pas lirim.

Qëllimi 3: Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit të Sistemit të Burgjeve

Për realizimin e këtij qëllimi u specifikua 1 objektiv kryesor, si dhe 2 produkte të pritshme për tu realizuar gjatë vitit 2015. Gjithashtu, u planifikuan 17 aktivitete për realizimin e produkteve.

Produkti 11: Staf i trajnuar mbi komunikimin me mediat, autoritetet lokale dhe marrëdhëniet me publikun në kuadër të menaxhimit të situatave emergjente dhe çështjeve sensitive në IEVP.

Me qëllim menaxhimit të duhur të marrëdhënieve me publikun, autoritetet lokale, organizata dhe mediat, ka nisur trajnimi i stafeve të IEVP në të gjithë vendin. Gjashtë module teorike që janë përfshirë në këtë trajnim kishin për qëllim përgatitjen e kapaciteteve komunikuese për përballimin e çdo situatë si dhe menaxhimit të kërkesave për informacion mbi punën dhe sigurinë në IEVP. Modulet u fokusuan mbi parimet bazë

të komunikimi publik, disa njohuri rreth kuadrit ligjor ekzistues mbi informimin publik (mbrojtja e të dhënave personale, e drejta e informimit etj), etikën e komunikimit si një element shumë i rëndësishëm për punën institucionale, mënyrën e përgatitjes së komunikatës publike/shkresës zyrtare, menaxhimin e situatave të vështira/të jashtëzakonshme në aspektin e informacionit dhe komunikimit etj.

Nga ana tjetër, është një fakt i njohur se mënyra e prezantimit të punës, dhënies së informacionit mbi ngjarjet në burgje apo edhe përgjigjet zyrtare ndaj institucioneve e organizatave marrin një rëndësi të veçantë, pasi shpesh këto informacione mund të keqinterpretohen, keqpërdoren apo edhe të shprehen gabim për shkak të njohurive të munguara në këtë fushë. Kryesisht, trajnimet mbi komunikimin publik i janë adresuar stafeve sociale në burgje, të cilët gjatë punës së tyre janë më shumë në kontakt me publikun qytetar, organizatat, institucionet apo mediat. Trajnimet u zhvilluan në IEVP Vaqarr, Mine Peza, Jordan Misja, Ali Demi dhe 6 IEVP në rrethe.

Produkti 12: Sistem trajnimi për avancimin në karrierë dhe nivelin e gradave të stafit me uniformë.

Në zbatim të angazhimeve të ndërmarra janë realizuar në masën 100% aktivitetet e planifikuara për vitin 2015 për realizimin e këtij produkti. Janë mbledhur të dhënat për punonjësit që duhet të përfshihen në trajnim për ngritjen në karrierë, janë grupuar dhe planifikuar trajnimet sipas nivelit të gradës, si dhe janë hartuar modulet e trajnimit. Duke iu referuar programit të trajnimit u trajnuan gjatë vitit 955 punonjës të niveleve të ndryshme, prej të cilëve 255 punonjës morën pjesë në sesione trajnimesh të organizuara në bashkëpunim me organizatat jo qeveritare të cilat operojnë në sistemin e burgjeve. Temat e trajnimit kanë qenë shumëplanëshe dhe operacionale për të ndihmuar në punën dhe praktikën e përditshme për realizimin me profesionalizëm të detyrave funksionale.

Qëllimi 4: Të përmirësoje standardet e përgjithshme infrastrukturore dhe kushtet në të cilat mbahen dhe trajtohen personat me liri të kufizuar.

Për realizimin e këtij qëllimi u specifikua 1 objektiv kryesor, si dhe 2 produkte të pritshme për tu realizuar gjatë vitit 2015. Gjithashtu, u planifikuan 11 aktivitete për realizimin e produkteve.

Produkti 13: Institucion penitenciar i ri në Fier i hapur dhe në funksion të plotë.

Me investim të Komisionit Evropian dhe Qeverisë Shqiptare, u bë e mundur hapja e paraburgimit të ri në Fier me një kapacitet prej 780 vendesh. Nëpërmjet instrumentit financiar (IPA) u akorduan nga Bashkimi Evropian për ndërtimin e këtij institucioni 14.3 milionë euro. Ndërkohë investimi nga Qeveria Shqiptare prej 1.2 milion euro është përdorur për pajisjen e objektit me sistem ngrohje, ftohje, sistem elektrik, hidraulik, rrjetin inxhinierik, kosto lokale. Paraburgimi i ri në Fier është ndërtuar sipas standardeve më bashkëkohore të Bashkimit Evropian, të cilat vijnë paralelisht me frymën e reformës në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, është në përputhje me vizionin e një drejtësie penale jo vetëm korrektuese, por edhe respektuese ndaj qenieve njerëzore.

Procedurat e rekrutimit të stafit Fier u kryen në mënyrë transparente, të plota dhe sipas kriterëve dhe standardeve të përcaktuara për përzgjedhjen e stafit në administratën publike shqiptare.

Mbipopullimi është një problematikë e ndjeshme për të gjithë sistemin penitenciar. Duke qenë se kjo çështje kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ka ndërmarrë një studim mbi shkaqet dhe efektet e mbipopullimit në sistemin e burgjeve. Ky studim është shoqëruar me hartimin e dokumentit të politikave *“Për uljen e mbipopullimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”*. Nëpërmjet këtij dokumenti synohet të prezantohet situata aktuale e zbatimit të politikave penale apo praktikave të organeve të drejtësisë penale që ndikojnë në shtimin e fluksit të popullimit në burgje dhe në institucionet e paraburgimit, si dhe të propozohen rekomandime mbi çështje që duhet të bëhen objekt i rivlerësimeve të mëtejshme nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e drejtësisë penale në vend. Konkluzionet e studimit janë prezantuar në një tryezë diskutimi, për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Dokumenti i Politikave do të shoqërohet gjatë vitit 2016 me një Plan Veprimi, ku do të adresohen masat konkrete për uljen e mbipopullimit në sistemin e burgjeve, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore në përmbushje të çdo aktiviteti që do të ndërmerret.

Institucionet të cilat kanë pasur mbipopullim gjatë vitit 2015 janë IEVP Korçë, Lezhë, Jordan Misja, Fushë Krujë, Elbasan, Rrogozhinë, Peqin, Tepelenë, Vlorë, Mine Peza, Krujë, Lushnjë, Ali Demi, Sarandë, Berat, Durrës, Tropojë dhe Spitali i Burgjeve. Shifrat e mbipopullimit kanë variuar nga hyrjet dhe daljet e personave me liri të kufizuar

Produkti 14: IEVP Jordan Misja e rikonstruktuar dhe në funksion të plotë

Me investim të fondeve të buxhetit të shtetit u rikonstruktuan plotësisht ambientet e Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Jordan Misja, Tiranë. Investimi kishte si objekt rritjen e kapaciteteve të burgut. Për këtë investim u alokua një fond prej 572 milion lekë të reja me TVSH nga buxheti i shtetit. Ndërhyrja në investime në këtë institucion është një tregues për vendosmërinë e përmirësimit të kushteve në të cilat mbahen dhe trajtohen personat e paraburgosur. Kushtet e mëparshme të institucionit nga disa organizata monitoruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ishin përcaktuar si denigruese dhe të papërshtatshme. Janë hartuar një sërë projektesh për përmirësimin e kushteve në IEVP. Si rrjedhojë e mungesës së fondeve nuk është bërë i mundur investimi përkatës.

Investime të tjera gjatë vitit 2015 përfshijnë:

- Duke parë nevojën për disa restaurime në mirëmbajtjen e ambienteve të regjimit të jashtëm dhe atij të brendshëm, gjatë muajit prill 2015 dhe në vazhdimësi administrata e Institutit të Miturve Kavajë realizoi disa ndërhyrje në mirëmbajtjen e ambienteve të institucionit. Konkretisht, janë lyer të gjitha fasadat e objektit në regjimin e jashtëm, duke përfshirë edhe magazinën, është pastruar dhe vijëzuar rruga hyrëse e institucionit; janë lyer të gjithë ambientet e punës në regjimin e brendshëm duke filluar me hyrjen, ambientin e pritjes së familjarëve, korridoret, holli i madh ku zhvillohen aktivitetet e të miturve, të katër sektorët në ambientet e përbashkëta dhe dhomat e të miturve. Gjithashtu, u pastruan dhe vijëzuan të gjitha ambientet sportive: fusha e futbollit/volejbollit ku zhvillohen aktivitetet e të miturve, duke përfshirë edhe zonat e ajrimeve; është ndërhyrë edhe në mjediset e gjelbëruara rreth institucionit, në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm. Vlen të

theksohet, se prej hapjes së këtij institucioni në vitin 2009 nuk është bërë asnjë rikonstruktion thelbësor.

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Save the Children inauguruan ambientet e reja të takimeve të miturve me familjarët e tyre. Gjatë vitit 2015 u ndërmor një nismë e rëndësishme që kishte për qëllim forcimin e marrëdhënieve të personave me liri të kufizuar me familjarët e tyre. Kjo nismë u jetësua përmes zbatimit të programit “Prindërimi në distancë”, i cili konsistoi në përshtatjen e ambienteve të takimit të personave të dënuar dhe të paraburgosur me familjarët e tyre. Pjesë e kësaj nisme ishte gjithashtu përshtatja e një ambienti të ri takimesh të miturve në Institutin e të Miturve në Kavajë me familjarët e tyre, i cili synonte krijimin e një atmosfere sa më miqësore.

Qëllimi 5: Të garantojmë standardet ushqimore për personat me liri të kufizuar të dënuar dhe të paraburgosur në burgje.

Produkti 16: Trajtimi me normë ushqimore i të dënuarve dhe paraburgosurve për vitin 2015. Realizuar në masën 100%.

Të dënuarve u sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, punën nga institucionet penitenciare. Ushqimi sigurohet për tri vaktet. Norma e ushqimit është në përputhje me urdhrin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë nr. 104/5 datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë, nr. 205/3 datë 27.07.2006 sipas kategorive; **2.615 k/kal** për të dënuar të papunësuar dhe të mitur; **3.033 k/kal** për të dënuar të punësuar; **3.345 k/kal** për të dënuar të sëmurë. Respektimi i tyre verifikohet nga shërbimi shëndetësor i IEVP, Komisioni i Pritjes së Mallit dhe stafi i kuzhinës. Buxheti për trajtimin ushqimor të dënuarve dhe paraburgosurve për dy vitet e fundit është:

Viti 2014 458,569,328 lekë

Viti 2015 498,742,470 lekë

Ndryshimet që vihen re në buxhetin e ushqimeve është si rrjedhojë e parashikimeve që janë bërë për numrin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Për të siguruar trajtimin ushqimor të dënuarve dhe paraburgosurve janë kryer inspektime të vazhdueshme për pritjen e ushqimeve të freskëta, kontrollin e tyre dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre nga furnitori në magazinë dhe kuzhinë, si dhe për respektimin e shumëllojshmërisë në gatimet, veçanërisht me ushqimet e freskëta, alternimi i ushqimeve në meny ripërtëritja e menysë, etj.

Qëllimi 6: Të forcojë masat antikorruption në Sistemin e Burgjeve

Produkti 15: Aktivitete të planifikuara dhe miratuara të Bordit të Antikorruptionit në Burgje.

Me qëllim forcimin e masave anti-korrupsion në sistemin e burgjeve, u planifikuan dhe u zhvilluan inspektime periodike e të vazhdueshme në IEVP nga bordi i Drejtorisë së Përgjithshme. Inspektimet u kryen nga përfaqësuesit e sektorëve në DPB gjatë të cilave janë analizuar disa faktorë, si: ankesat e të burgosurve të kontaktuar drejtpërdrejtë, procedurat e dhënies së lejeve, futja e sendeve të ndaluara, zbatueshmëria e legjislacionit në fuqi, raportimet nga organizatat e ndryshme që monitorojnë sistemin e burgjeve apo

institucione që zhvillojnë programe të ngjashme (Avokati i Popullit) etj. Me këtë qëllim u ngrit dhe nisi përpunimi i të dhënave në një Database specifik në muajin tetor 2015, i cili u përditësua me të dhëna në mënyrë të vazhdueshme.

Raporti vjetor i Bordit Antikorrupsion i cili do të publikohet në faqen zyrtare online gjatë muajit shkurt 2016.